

## KOMISIONI NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR PROGRAMI I KOSOVËS

### FTESË PËR PROPOZIME PËR GRANTE TË VOGLA TË ICMP-SË PËR SHOQATAT FAMILJARE PËR PERSONAT E ZHDUKURA DHE ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NGA KONFLIKTI I KOSOVËS - 2025

DATA E LËSHIMIT: 17 JANAR 2025

DATA E MBYLLJES: 14 SHKURT 2025

#### I. PROGRAMI I GRANTEVE TË VOGLA TË KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR (ICMP)

Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) fton shoqatat familjare të personave të zhdukur dhe organizatave të tjera joqeveritare (të shoqërisë civile) që të aplikojnë për Programin e saj të Granteve të Vogla për Shoqatat Familjare të Personave të Zhdukur dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, programi i Kosovës, 2025.

ICMP është një organizatë ndërkombëtare e pavarur, e bazuar në traktate, me më shumë se 20 vjet përvojë në 40 vende. Është e vetmja organizatë ndërkombëtare e ngarkuar ekskluzivisht për të punuar në çështjen e personave të zhdukur. Ajo ndihmon qeveritë të ndërtojnë institucione të sundimit të ligjit që kërkojnë dhe identifikojnë me sukses dhe në mënyrë të paanshme personat e zhdukur dhe mbështet përpjekjet për t'u mundësuar familjeve të të zhdukurve të pohojnë të drejtat e tyre.

#### II. PËR PROGRAMIN ICMP NË KOSOVË

ICMP ka për qëllim të trajtojë çështjen komplekse të personave të zhdukur nga konflikti në Kosovë dhe përtej kufijve shtetërorë dhe etnikë. Bashkëpunimi afatgjatë i ICMP-së me familjarë e të zhdukurve dhe institucioneve shtetërore relevante në Kosovë dhe Serbi është thelbësor për këtë përpjekje, duke vënë theksin në angazhimin e familjarve të të zhdukurve, duke ofruar asistencë teknike dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore. Ky është çelësi për krijimin e një procesi të qëndrueshëm ku qeveritë përmbushin detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut për të hetuar rastet e personave të zhdukur dhe për ndërtimin e besimit midis familjeve të të zhdukurve në institucionet shtetërore.

#### III. PROGRAMI I GRANTEVE TË VOGLA TË ICMP-SË

Nëpërmjet Programit të saj të Granteve të Vogla, ICMP ofron mbështetje financiare për shoqatat e familjeve të personave të zhdukur dhe organizatave të shoqërisë civile (OSC) për të zbatuar projekte që integrojnë objektivat, qasjet, aktivitetet dhe përmbytjet që kontribuojnë në:

- Afirmimi i rolit të shoqërisë civile në promovimin e përgjegjësisë shtetërore për çështjen e personave të zhdukur;
- Nxitja e qasjeve të paanshme, jo diskriminuese, jo-sektare, multietnike dhe jo politike për

çështjen e të zhdukurve;

- Përbushja e të drejtave të anëtarëve të mbijetuar të familjarëve të personave të zhdukur; dhe
- Promovimi i barazisë gjinore dhe përkrahja e lidërshipt të gruas midis komuniteteve të afektuara.

#### IV. FUSHAT E MBËSHTETJES

Projektet dhe aktivitetet e mbështetura për Programin e Granteve të Vogla për Shoqatat Familjare (SHF) të Zhdukura dhe të Organizatave të Shoqërisë Civile, Programi Kosovë 2025, duhet të jenë relevante për rolin dhe sfidat me të cilat përballen familjet e të zhdukurve dhe shoqërisë civile në Kosovë dhe rajon duhet të synojnë/adresojnë të paktën një nga objektivat e mëposhtme:

- Ngjarje të përbashkëta përkujtimore midis SHF në Kosovë dhe Serbi përmes shënimit të datave të rëndësishme si Dita Ndërkombëtare e të Zhdukurve (30 gusht);
- Shënimi i datave të rëndësishme përkujtimore duke përdorur modele inovative dhe gjithëpërfshirëse;
- Avokim për llogaridhënien e shtetit në zgjidhjen e rasteve të personave të zhdukur;
- Aktivitetet për forcimin e rrjetëzimit ndërmjet shoqatave të familjeve të personave të zhdukur nga Kosova, brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë;
- Takime për shkëmbimin e informacionit me institucionet përkatëse vendase dhe organizatat ndërkombëtare të përfshira në procesin e personave të zhdukur për të diskutuar tema me interes për familjet e personave të zhdukur me tema por pa u kufizuar në:
  - Përpjekjet për zgjidhjen e rasteve të NN (*nomen nescio*/të paidentifikuara);
  - Legjislacioni përkatës lidhur me procesin e personave të zhdukur;
  - Prezantimi i një raporti të zhvarrimeve të përgatitur nga institucionet përkatëse vendore në fund të çdo viti të zbatimit të projektit.

Projektet e shoqatave familjare dhe OSC-ve që ICMP ka mbështetur nëpërmjet programeve të Granteve të Vogla në të kaluarën kanë përfshirë shembujt e mëposhtëm:

- Përmirësimi i dukshmërisë, ndërgjegjësimit dhe kuptimit të çështjes së personave të zhdukur nëpërmjet ekspozitave, botimeve dhe ngjarjeve përkujtimore;
- Nxitja e dialogut midis familjeve të të zhdukurve dhe midis familjeve dhe autoriteteve;
- Përgatitja ose shpërndarja e kërkimeve, sondazheve dhe vlerësimeve akademike ose ligjore.
- Organizimi i eventeve të lidhura me avokimin, promovimin e politikave; iniciativa sensibilizuese, fushata publike për çështjen e të zhdukurve;
- Krijimi ose forcimi i rrjeteve lokale, rajonale ose mbarëkombëtare të familjeve të të zhdukurve ose OSC-ve që punojnë për çështjen e të zhdukurve;

Projektet që si objektivi parësor përfshijnë përpunimin e të dhënave personale lidhur me personat e zhdukur ose të afërmit e tyre, apo projektet e fokusuar vetëm në dhënien e ndihmës psikosociale për familjet e të zhdukurve nuk janë të pranueshme për financim nëpërmjet kësaj Thirrjeje.

**Kostot e pranueshme:** për t'u siguruar që organizatat të zbatojnë aktivitetet dhe të arrijnë rezultatet e përmendura më sipër, kostot e mëposhtme janë të lejuara:

<b>Kostot programore</b>	Çdo shpenzim që lidhet me një program, projekt apo aktivitet të caktuar që nuk bën pjesë në kostot e përsëritura të organizatës, për shembull: konsulentët, transporti i pjesëmarrësve, vaktet, akomodimi, vendi i qirasë, sistemi i zërit, shërbimet, ndihma për kujdesin ndaj fëmijëve gjatë ngjarjeve dhe takimeve, shtypshkronja, materialet për ngjarjet.
<b>Kostot e organizatës</b>	Çdo shpenzim për të mbuluar kostot e përsëritura që lidhen me ekzistencën e dhënësve si organizatë apo shoqatë, duke përfshirë pagat duke përfshirë sigurimet shoqërore ose shpenzimet e zyrës së konsulentëve, pajisjet, materialet, shpenzimet e udhëtimit për personelin.

## V. SHUMA E GRANTEVE, PRANUESHMËRISË, PARAQITJEVE DHE SHPËRBLIMEVE

Aplikantët mund të kërkojnë deri në 6,000.00 EURO për çdo projekt. Aplikantët mund të paraqesin vetëm një propozim projekti sipas kësaj thirrjeje për propozime.

### 5.1. Pranuesi

- **Shoqatat e Familjare të Personave të Zhdukur (SHF)/ Organizata e Shoqërisë Civile (OJQ):**
  - ✓ që janë të regjistruara ligjërisht si organizatë jofitimprurëse e shoqërisë civile në Kosovë;
  - ✓ që kanë treguar përvojë në realizimin e projekteve prej së paku 2.000.00 Euro;
  - ✓ që kanë treguar përvojë të menaxhimit të shëndoshë financiar, gjë që dëshmohet nga përgatitja e raporteve financiare vjetore;
  - ✓ Që aplikojnë për projekte që trajtojnë drejtpërdrejt çështjen e personave të zhdukur

ICMP do të pranojë aplikimet e paraqitura nga organizata të vetme, por **inkurajon aplikimet e përbashkëta të paraqitura nga dy ose më shumë aplikantë.**

Aplikimet do të dorëzohen në gjuhën angleze, serbe dhe shqipe duke përdorur formularët ICMP përmes emailit.

### 5.2. Afati i fundit për paraqitjet për projekte: 14 Shkurt 2025

Njoftimet e përzgjedhjes priten në mënyrë treguese nga ajo e fundit e 7 marsit 2025. Projektet priten të fillojnë më 1 prill 2025 pas nënshkrimit të kontratës dhe mund të kenë kohëzgjatje jo më shumë se 6 muaj.

Shoqata familjare/Organizatata e Shoqërisë Civile ftohen të paraqesin aplikimet e tyre duke përdorur formularët e ICMP-së deri në afatin e paraqitjes më 28 shkurt 2025 në orën 17:00 me orën e Evropës Qendrore (CET).

Aplikimet do të shqyrtohen nga pranuesi dhe aplikantët mund të kontaktohen për të dhënë sqarime. Grantet e dhëna mund të jenë subjekt i modifikimeve nga propozimi origjinal i paraqitur. ICMP rezervon të drejtën të financojë ndonjë ose asnjë nga aplikimet e marra.

Të gjitha aplikimet duhet të përmbajnë:

- Propozimi i projektit;
- Propozimi i buxhetit
- Profili i organizatës.

Për të nxitur aksesin e barabartë të grave në procesin e personave të zhdukur, ICMP do të inkurajojë aplikimet që nxisin barazinë gjinore në lidhje me çështjen e personave të zhdukur.

Ju lutem ndiqni linkun më poshtë për të hyrë në formularët:

Linku: <https://upload.icmp.int/s/3HLJe84rzHPK4j6>

Formularët e aplikimit mund të kërkohen dhe pyetjet rreth kësaj Thirrjeje mund të bëhen nëpërmjet email: [Kosovo.SmallGrants@icmp.int](mailto:Kosovo.SmallGrants@icmp.int)



*Programi i Granteve të Vogla të ICMP-së KOSOVË 2025 - 2026 financohet nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë*

ICMP.CSI.SG.WB.057.1.W.alb.doc  
Sarajevë, 20 Janar 2025